

KOMUNËS SË PRISHTINËS
Kryetarit, z. Isa Mustafa

Prishtinë, 26 shtator 2012

Kërkesë për caktimin e lokacionit për bustin e poetit Ali Podrimja

I nderuar zoti Kryetar,

Sikundër e kemi bërë të ditur, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka marrë përsipër përkujdesjen për valorizimin e veprës dhe të figurës së poetit Ali Podrimja. Në këtë kuadër, Akademia është duke bërë përgatitjet për botimin e veprës së plotë të poetit Podrimja në disa vëllime dhe, bashkë me këtë, për gjetjen e formës më të përshtatshme, në bashkëpunim me institucionet e Kosovës, për valorizimin e figurës së poetit të shquar. Vitin e ardhshëm, në përvjetorin e vdekjes, do të ishte e përshtatshme që, bashkë me promovimin e kompletit të veprave, të inaugurohet edhe busti i Ali Podrimjes, në ndonjë lokacion të përshtatshëm të qytetit të Prishtinës. Për ta realizuar këtë, komuna e Prishtinës do të duhej të caktonte lokacionin, por njëkohësisht të japë edhe kontributin e saj në ngritjen e bustit dhe për rregullimin të infrastrukturës përcjellëse.

Me këtë rast, Akademia e konsideron të nevojshme të theksojë se poeti Ali Podrimja ishte njëri nga shkrimtarët dhe poetët më të njohur të letërsisë shqipe, poeti emblematik i Kosovës, dhe se poezia e tij tashmë është pjesë e trashëgimisë letrare dhe kulturore mbarëshqiptare. Vlerat e veprës së Podrimjes konsiderohen të qëndrueshme dhe se ato do t'ju shërbejnë brezave të ardhshëm për edukim kulturor kombëtar. Më anë tjetër, Ali Podrimja krejt veprimtarinë e tij letrare-artistike, sikundër edhe atë kulturore dhe shoqërore e ka zhvilluar në komunën dhe qytetin e Prishtinës, kështu që edhe nga kjo pikëpamje qyteti i Prishtinës do të duhej të përmbushte një obligim moral ndaj poetit.

Zoti Kryetar,

Lidhur me ngritjen e bustit të poetit Ali Podrimja, Akademia është e gatshme të bashkëpunojë me organet përkatëse të Komunës së Prishtinës, në mënyrë që për ngritjen e një monumenti përkujtimor për Ali Podrimjen të gjendet zgjidhja më e mirë, qoftë kur bëhet fjalë për lokacionin, qoftë për zgjidhjet teknike dhe artistike që lidhen me bustin dhe infrastrukturën e monumentit. Njëkohësisht, e konsiderojmë të nevojshme të kërkojmë shqyrtimin me prioritet të kësaj kërkesë, në mënyrë që vonesat eventuale të mos i japin kuptimin e harresës një çështjeje me interes si për Akademinë, ashtu edhe për Komunën e Prishtinës.

Me respekt,

Akademik Hivzi Islami,

Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës